


Fakte të shpejta

- Mjeku dhe ekipi i kujdesit shëndetësor mund t'ju ndihmojnë të vendosni nëse hospis është kujdesi i duhur për ju.
- Pasi të regjistroheni në hospis, mund të vazhdoni të mbani ende kontakt me ekipin e kujdesit të onkologjisë.
- Hospis do të ofrojë kujdes për menaxhimin e dhimbjes dhe të simptomave.
- Hospis do t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj në marrjen e vendimeve në lidhje me kujdesin tuaj gjatë gjithë rrugëtimit.
- Disponohen shërbime mbështetëse për ju dhe familjen ose kujdestarët tuaj.
- Hospis mbulohet nga Medicare, Medicaid dhe shumica e kompanive private të sigurimit.

Studimet tregojnë se pacientët jetojnë më gjatë dhe kanë cilësi më të mirë jete në hospis.



KUJDESI OFROHET NGA NJË
EKIP PROFESIONISTËSH DHE
VULLNETARËSH ME PËRVOJË
DHE MUND TË PËRFSHIJË:



Hospis është një shërbim kujdesi dhe mbështetjeje për individët që po përballen me një sëmundje kufizuese për jetën dhe diagnozë terminale.

MOQC
MICHIGAN ONCOLOGY
QUALITY CONSORTIUM


Blue Cross
Blue Shield
of Michigan
Nonprofit corporations and independent licensees
of the Blue Cross and Blue Shield Association

Pyetje që mund
të keni rreth
HOSPIS





ZGJEDHJA E HOSPIS

SI TA DI QË HOSPIS ËSHTË KUJDESI I DUHUR PËR MUA?

Nëse ju është thënë se keni një sëmundje kufizuese për jetën, kujdesi hospis është një opsion për ju.

ÇFARË ËSHTË HOSPIS DHE ÇFARË BËN EKIPI I HOSPIS?

- Hospis është një shërbim që ofron kujdes lehtësues dhe mbështetje dashamirëse për individët që po përballen me një diagnozë terminale
- Hospis mbështet personin dhe ekipin e tij të mbështetjes
- Hospis punon për të siguruar plotësimin e nevojave fizike dhe emocionale të personit
- Hospis i mundëson personit të përballlet me dinjitet me diagnozën

SI TË ZGJEDH INSTITUCIONIN HOSPIS QË ËSHTË I PËRSHTATSHËM PËR MUA NËSE KA DISA INSTITUCIONE TË TILLA QË MUND TË KUJDESEN PËR MUA?

- Caktoni një seancë informuese pa pagesë në çdo hospis
- Vizitoni [medicare.gov/hospicecompare](https://www.medicare.gov/hospicecompare) për të kërkuar për agjenci hospis pranë jush
- Diskutoni me mjekun dhe ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor

KUJDESI HOSPIS

KU MUND TË MARR KUJDES HOSPIS?

- Shtëpi
- Shtëpi të moshuarish të pajisur me staf të specializuar (Skilled Nursing Facility, SNF)
- Qendra rezidenciale kujdesi (Assisted Living Facility, ALF)
- Qendra kujdestarie për të rriturit (Adult Foster Care, AFC)
- Shtëpi kujdesi hospis
- Kudo ku jetoni

SA SHPESH DO TË VIZITOHEN NË HOSPIS PASI TË JEM PACIENTI I SAJ DHE SA I PERSONALIZUAR DO TË JETË KUJDESI IM?

Të gjitha hospiset do të personalizojnë kujdesin që do të merrni dhe do t'ju vizitojnë bazuar në nevojat tuaja. Të gjithë pacientët në hospis do të kenë akses në një mjek, infermier, punonjës social, kujdes shpirtëror, ndihmës të hospisit dhe vullnetarë.

Stafi është në dispozicion për urgjencë dhe pyetje 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

A MUND TA NDËRPRES MARRJEN E KUJDESIT HOSPIS?

Mund ta ndërpritni në çdo kohë kujdesin hospis dhe të regjistroheni sërish nëse dhe kur të jeni gati.

SHËRBIMET SHITESË

A KA SHËRBIME TË TJERA TË DISPONUESHME PËR MUA?

Disa hospise mund të ofrojnë masazh, muzikë, terapi arti ose me kafshë shtëpiake. Pyesni për shërbimet e disponueshme.

CILAT JANË DISA GJËRA QË BËJNË VULLNETARËT E HOSPIS?

Vullnetarët janë vizitorë miqësorë që mund të ofrojnë shoqëri dhe mbështetje.

ÇFARË NDODH NËSE KUJDESTARI IM KA NEVOJË PËR “PUSHIM”?

Nëse kujdestari juaj ka nevojë për pushim gjatë ofrimit të kujdesit të përditshëm, flisni me ekipin e hospis. Ekipi mund të diskutojë për mundësitë e disponueshme dhe të planifikojë një shërbim që plotëson nevojat tuaja apo të familjes suaj.

A DISPONOHEN SHËRBIME PAS VDEKJES?

Ofrohen shërbime pas vdekjes, duke përfshirë mbështetje individuale dhe në grup, këshillim dhe shërbime të tjera.